




GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS



VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA  
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF

KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS		REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS		VRHOVNI SUD KOSOVA
G.J.A-Su.A	<u>770/13</u>	
Dt:	<u>18.12.2013</u>	
PRISHTINË - PRISTINA		

Date: 12.12.2013

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës dhe Gjyqtarëve të EULEX-it, në bazë të nenit 18 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 12.12.2013 dha këtë

MENDIM JURIDIK

“Vepra e parashikuar nga neni 317. i KPK konsumohet vetëm në rastet kur shuma e detyrimeve doganore të mallrave të importuara ose të eksportuara ilegalisht tejkalon shumën prej 5000 euro”, ndërsa kur ajo është nën këtë shumë, bëhet fjalë për delikt administrativ.

A r s y e t i m i

Drejtori i Doganave të Republikës së Kosovës dhe Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë i janë drejtuar Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës me kërkesë për të dhënë Mendim juridik në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 317 të KPK.

Sipas parashtruesve të kërkesës, dilema qëndron në atë se a konsiderohet veprë penale çdo abuzim me dispozitën e nenit 317 të KPK apo vetëm në rastin kur shuma e

detyrimeve doganore të mallrave të importuar ose të eksportuar ilegalisht kalon shumën prej 5000 €, ?.

Ekziston vepra penale e parashikuar nga neni 317 të KPK, në të gjitha aspektet e saj, vetëm po qe se shuma e detyrimeve doganore, të mallrave të importuar apo të eksportuara ilegalisht tejkalon shumën prej 5000€, për arsyet si më poshtë:

Në neni 8. i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës Nr. 03/L-109, thuhet:

“Në rastet e parashikuara në nenin 273 të ish Kodit Penal të Kosovës (*kontrabandimi me mallra, tani neni 317*), kur shuma e detyrimeve doganore të mallrave të importuara apo të eksportuara ilegalisht nuk e kalon shumën prej pesëmijë (5.000) Euro, në vend të dënimit penal do të aplikohet gjoba administrative. Gjoba administrative do të konsiston në gjobë në të holla prej dyfishin e shumës së detyrimeve deri dhjetëfishin e detyrimeve, gjobë e cila do t’i jepet personit përgjegjës ( kryesit ) nga zyra përkatëse doganore”.

Me dispozitat kalimtare të KPK, përkatësisht nenin 439, janë shfuqizuar rregulloret e UNMIK-ut dhe Kodi Penal i Kosovës (UNMIK REG 2003/05), si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, që mbulojnë çështjet e trajtuara në këtë Kod, d.m.th., janë shfuqizuar vetëm ato dispozitat ligjore që rregullojnë çështje penale që tani rregullohen me këtë Kod, por jo edhe dispozitat që rregullojnë deliktet administrative. Neni 8 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës, nr. 03/L-109, nuk i trajton si çështje penale rastet kur shuma e detyrimeve doganore të mallrave të importuara apo të eksportuara ilegalisht nuk e tejkalon shumën prej 5000 euro.

Me respekt

Dr.sc. Fejzullah Hasani

Kryetar i Gjykatës Supreme të republikës së Kosovës